**VENDIM**
**Nr. 68, datë 27.5.2016**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË "RREGULLAT E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"**

Në mbështetje të neneve 16; 81, pika 2, 99 dhe 110, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" dhe nenit 26 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me "Miratimin e një ndryshimi në rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Në datën 30.3.2016, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 244, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike".
- Në nenin 99, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", parashikohet se: "Çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.".
- Në nenin 14, pika 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, është parashikuar se: "Këto rregulla do të shërbejnë si model i përkohshëm për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, deri në miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e një ndryshimi në "Rregullat e tregut" miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, si më poshtë:

Në kapitullin IX, pika 1.3, germa "g", ndryshon përmbajtja si më poshtë:

a) "Duke filluar nga 1 korriku 2016, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike, me përjashtim të subjekteve të përcaktuar në ligjin nr. 138/2013, "Për burimet e rinovueshme dhe sipas pikës 4, të nenit 99, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

b) Klientët fundorë që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal nuk janë përgjegjës për disbalancat kundrejt këtij të fundit.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a. dhe palët e tjera të interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**